



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS TABLE TENNIS FEDERATION OF KOSOVO

Ne baze te nenit 14 te Rregullores për reprezentacionet e pingpongut të Kosovës e në pajtim me nenin 44 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës Bordi i FPPK-së në mbledhjen e datës 22.10.2019 nxori Vendim që të publikoi këtë:

KONKURS

Për postin e Selektorit të reprezentacionit të Kosovës në pingpong

KUSHTET

Një person për t'u emëruar Selektor duhet të plotësoj këto kushte:

- Diploma/Certifikata mbi Përgatitjen e tij profesionale
- 3 (tri) vite përvojë pune ne sportin e pingpongut,
- Rezultate të çmuara në sportin e Pingpongut.
- Preferohet njohja e gjuhës angleze.

Përshkrimi i detyrave të Selektorit

Përpilon:

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së reprezentacionit,
- Propozimin e planit të përgatitjeve të reprezentacionit,
- Propozimin e kalendarit të garave të reprezentacionit për sezonin e ardhshëm, duke marrë parasysh që garat lokale të jenë në funksion të paraqitjes sa më të suksesshme të reprezentacionit në gara ndërkombëtare,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për reprezentacion për vitin e ardhshëm.

Vërteton propozimet për:

- listën e gjerë dhe të ngushtë të kandidatëve për reprezentacion,
- vendin, kohën dhe terminin e mbajtjes së përgatitjeve,
- reprezentuesit për lëvdata dhe shpërblime në bazë të rezultateve të arritura,
- trajnerët e reprezentacionit (meshkujve dhe femrave) si dhe trajnerët e seleksioneve.

Udhëheq dhe koordinon:

- punën e të gjithë trajnerëve të reprezentacioneve dhe vërteton raportin me shkrim për punën e tyre (mujore dhe vjetore).
- Përgatitjet për paraqitjet e reprezentacionit,
- Seleksionin gjegjës në paraqitje në vend dhe jashtë vendit, me ç 'rast në bashkëpunim me trajnerin vendos për
- përbërjen e ekipit për gara ndërkombëtare,
- Përveç trajnerit, me punën e të gjithë personave tjerë të angazhuar për nevoja të reprezentacionit (udhëheqësi teknik i përgatitjeve, sekretari teknik i reprezentacionit, etj).
- Përzgjedhësi përcjell përparimin dhe zhvillimin e lojtarëve të moshave të reja, kandidatëve potencial për reprezentacion, si dhe punën, rezultatet dhe formën e seleksioneve tjera.
- Në fund të sezonit garues Përzgjedhësi i dorëzon Kuvendit raport me shkrim për punën dhe rezultatet në sezonin paraprak, me vlerësimin e rezultateve të arritura, si dhe vlerësimin e punës së të gjithë trajnerëve të angazhuar.
- Selektori është i pavarur në punën e tij. Për punën e tij Selektori i përgjigjet Bordit së FPPK-së.

MANDATI

- 4 vjeçar me mundesi te rizgjedhjes edhe per nje mandat

AFATI I PARAQITJES

Afati i aplikimit është 8 dite duke filluar nga data **20.01.2020 deri me 27.01.2020.**

Aplikacioni i kompletuar duhet të përmbajë

- Cv
- Diploma universitare
- Certifikata për kryerjen e Nivelit I apo II për trajner ndërkombtar
- Dëshmi për punën aktive në tri vitet e fundit me gjeneratat e reja
- Dëshmi për rezultate e arritura
- Certifikatë për njohjen e gjuhës angleze
- Planifikimin e punës me trajner dhe lojtar
- Planin një vjeçar të punës si selektor

Dokumentacioni i kompletuar duhet të të dergohen në email adresen : **fppk@fppk.com** ose të shtypura në Zyren e FPPK-se..

Prishtine
17.01.2020

Bordi i FPPK